VENDIM
Nr. 181, datë 27.3.2024

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I SHKOLLËS 9-VJEÇARE, ARBANË", BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare, Arbanë", Bashkia Tiranë.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "truall", me një vlerë të përgjithshme prej 423 129.70 (katërqind e njëzet e tre mijë e njëqind e njëzet e nëntë pikë shtatëdhjetë) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 423 129.70 (katërqind e njëzet e tre mijë e njëqind e njëzet e nëntë pikë shtatëdhjetë) lekësh, përballohet nga Bashkia Tiranë.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Tiranë.
6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Tiranë.
8. Bashkia Tiranë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 2, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.
12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 2 dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONA PRIVATE E TË CILËVE SHPRONËSOHET, PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "NDËRTIMI I SHKOLLËS 9-VJEÇARE, ARBANË", BASHKIA TIRANË

NR.	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE SIPAS KARTELËS SË PASURISË										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM				SHËNIME (kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë)
														TRUALL			VLERA TOTALE (lek)	
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Truall (m^2)	Ndërtesë (m^2)	Arë (m^2)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lek/m^2)	Vlera (lek)		
1	TRASHËGIMTARËT E FAMILJES ALLAMANI Fatime Duro, Fatbardha Pepa, Meliha Celkavaja, Makbule Toska, Sanije Allamani, Ardit Allamani, Mehmet Allamani, Bledar Allamani, Shefqet Preza, Elizabeta Preza, Nafize Kurti, Asllan Hysenaj, Astrit Hysenaj, Arjan Hysenaj			Arbanë, Tiranë	1032	102/6	truall	990.00	990.00	0	0	2	110	734.62	490	359,963.80	359,963.80	Konfirmuar nga ASHK-ja Përshkrim: Seksioni E- Fatime Duro 24/160 Fatbardha Pepa 24/160 Meliha Celkavaja 24/160, Makbule Toska 24/160 Sanije Allamani 6/160 Ardit Allamani 6/160, Mehmet Allamani 6/160 Bledar Allamani 6/160 Shefqet Preza 10/160 Elizabeta Preza 10/160 Nafize Kurti 5/160 Asllan Hysenaj 5/160 Astrit Hysenaj 5/160 Arjan Hysenaj 5/160
2	TRASHËGIMTARËT E FAMILJES ALLAMANI Fatime Duro, Fatbardha Pepa, Meliha Celkavaja, Makbule Toska, Sanije Allamani, Ardit Allamani, Mehmet Allamani, Bledar Allamani, Shefqet Preza, Elizabeta Preza, Nafize Kurti, Asllan Hysenaj, Astrit Hysenaj, Arjan Hysenaj			Arbanë, Tiranë	1032	102/18	truall	5250.00	5250.00	0	0	2	249	126.36	490	61,916.40	61,916.40	Konfirmuar nga ASHK Përshkrim: Seksioni E- Fatime Duro 24/160 Fatbardha Pepa 24/160 Meliha Celkavaja 24/160 Makbule Toska 24/160 Sanije Allamani 6/160 Ardit Allamani 6/160 Mehmet Allamani 6/160 Bledar Allamani 6/160 Shefqet Preza 10/160 Elizabeta Preza 10/160 Nafize Kurti 5/160 Asllan Hysenaj 5/160 Astrit Hysenaj 5/160 Arjan Hysenaj 5/160
3	TRASHËGIMTARËT E FAMILJES ALLAMANI Fatime Duro, Fatbardha Pepa, Meliha Celkavaja, Makbule Toska, Sanije Allamani, Ardit Allamani , Mehmet Allamani, Bledar Allamani , Shefqet Preza, Elizabeta Preza, Nafize Kurti, Asllan Hysenaj, Astrit Hysenaj, Arjan Hysenaj			Arbanë, Tiranë	1032	102/23	truall	180.00	180.00	0	0	3	7	2.55	490	1,249.50	1,249.50	Konfirmuar nga ASHK-ja Përshkrim: Në këtë pasuri ndodhet ndërtesa e regjistruar ne volum 3 faqe 110. Kjo ndërtesë nuk preket nga shpronësimi. Seksioni E- Fatime Duro 24/160 Fatbardha Pepa 24/160 Meliha Celkavaja 24/160 Makbule Toska 24/160 Sanije Allamani 6/160 Ardit Allamani 6/160 Mehmet Allamani 6/160 Bledar Allamani 6/160 Shefqet Preza 10/160 Elizabeta Preza 10/160 Nafize Kurti 5/160 Asllan Hysenaj 5/160 Astrit Hysenaj 5/160 Arjan Hysenaj 5/160 kalon shtet me VKM shpronësimi vijon në vol. 3 f. 159. Sqarim: Sipërfaqja e shpronësimit prej 2.55 m^2 nuk afektohet me sipërfaqen e shpronësuar me VKM-në, sipas këtij shënimi.
	Vlera totale													863.53			423,129.70	